



Perspektiva juaj
është sfida jonë!

Fondi më i ri në fushën e investimeve

Raport Muaji Korrik 2023

Informacion bazë

Administrimi i Fondit	Raiffeisen Invest sh.a
Monedha	LEK
Datë Lancimi	20 Gusht 2018
Datë e mbarimit te Ofertes	03 Shtator 2018
Fillestare	
Vlera fillestare e kuotës	1,000
Shuma fillestare minimale	30,000
Shuma minimale pasuese	10,000

Komisione dhe Tarifa

Tarifë në hyrje	0%
Tarifë në dalje	2% (cdo shlyerje para 2 viteve)
Tarifë Administrimi në vit	Deri ne 1.15% e vleres neto te aseteve

Tarifa te tjera te vazhdueshme **Referojuni prospektit te fondit**

Komisione/tarifa e vazhdueshme **1.28% per vitin 2022**

Kosto për transfertë fondesh nga palë të treta **Referojuni informacionit ne degët e RBAL**

Objektivi i investimit dhe profili i investitorit

Objektivi i Fondit është të maksimizojë kthimin total afatmesëm, duke synuar të ruajë kapitalin e investitorit dhe të sigurojë likuiditet të mjaftueshëm.

Fondi synon të ketë një portofol investimesh të përqëndruar kryesisht në instrumente borxhi të emetuara ose garantuara nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë.


Për të maksimizuar kthimin total nga investimi, Fondi synon investime afatgjata dhe për këtë arsye, fondi investon të paktën 50 – 80% të aseteve ne obligacione afatgjatë te Qeverisë shqiptare.

Shifra e tarifas së vazhdueshme 1.28% mbështetet në shpenzimet për vitin e mbyllur më 31.12.2022. Kjo shifër mund të ndryshojë nga viti në vit. Tarifa totale e vazhdueshme nuk mund të kalojë maksimumin prej 1.4% ne vit te vlerës neto të aseteve te fondit.

Kostot e transaksioneve janë sipas kushteve të punës të palëvendërmjetësuese dhe nuk përfshihen në llogaritjen e komisioneve dhe tarifave të vazhdueshme, por ato i ngarkohen Fondit.

Profili i Riskut dhe Përfitimit

Risk i ulët Risk i lartë
Përfitimet tipike më të ulëta Përfitimet tipike më të larta




Profili i parashikuar i Riskut dhe Përfitimit të fondit Raiffeisen Vizion i përket kategorisë së tretë. Ky nivel i treguesit është rezultat i aplikimit të politikës së investimit të fondit me të dhënat historike të normave të interesit për 5 vitet e fundit. Treguesi i riskut dhe përfitimit korrespondon me një numër të plotë i cili përdoret për të renditur fondin në një nivel risku nga 1 në 7, sipas nivelit të rritjes të luhatshmërisë. Kategoria më e ulët nuk do të thotë që investimi në fond është pa risk. Ky tregues ka për qëllim tju informojë mbi luhatshmërinë e çmimit të kuotës së fondit bazuar në historikun e performancës së fondit. Të dhënat historike të përdorura për llogaritjen e treguesit nuk mund të përbëjnë një siguri të plotë për profilin e riskut në të ardhmen.

Të dhëna për Fondin në 31.07.2023

Vlera Neto e Aseteve	9,463,817,398
Numri i investitoreve	3,774
Cmimi i Kuotes	1,160.8674
*Kthimi vjetor neto nga investimi (31.07.2022 – 31.07.2023)	5.35%

*Tarifa e administrimit dhe tarifat e tjera të vazhdueshme zbriten përpara llogaritjes së kthimit nga investimi

Struktura e portofolit të investimeve në 31 Korrik 2023



Ne kuader të politikës së investimit të fondit Vizion, investimet kryhen kryesisht në obligacione thesari, të emetuara ose garantuara nga Qeveria shqiptare, përmes pjesëmarrjes në ankandet e tregut primar dhe transaksioneve në tregun sekondar.

Politika e investimit parashikon që të pakten 50 – 80 % e asetëve të fondit të investohen në obligacione afatgjate të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë. Fondi mban një pjesë të asetëve në depozita afatshkurtra për të plotësuar në çdo kohë nevojat për likuiditet të investitorëve. Vlera neto e asetëve të fondit është në nivelin e LEK 9.5 miliardë në datë 31 Korrik 2023.

Instrumenti

Ne % të Asetëve të Fondit

Obligacione Thesari

87.72%

Depozita / Llogari rrjedhese/ Te arketueshme

12.28%



Bonot e thesarit 12 mujore emetohen dy here në muaj; Obligacionet 2 vjeçare një here në muaj; 7 dhe 10 vjeçare janë me të rralla, afersisht një here në tre muaj. Qeveria organizon ankande të obligacioneve referencë 5 dhe 3-vjeçare me frekuencë një here në 2 muaj për secilin maturitet.

Zhvillimet dhe ecuria e normave te interesit te titujve te Qeverise Shqiptare gjate muajit Korrik

Norma bazë e interesit e publikuar nga Banka e Shqipërisë vijon të jetë në nivelin 3.00%. Politika monetare e ndjekur këte periudhë ka dhënë efektet e saj, duke bërë që inflacioni të shënojë rënie gjatë muajve të fundit. Norma e inflacionit në muajin Korrik ra në 4.20%, krahasuar me 4.50% në muajin Qershor. Normat e interesit të bonove dhe obligacioneve të Qeverisë Shqiptare në të cilat Fondi Vizion investon kanë pësuar rënie gjatë vitit 2023. Asetet e Fondit Vizion janë të investuara vetëm në bono dhe obligacione të emetuara nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe për këtë arsye Fondi është i ekspozuar ndaj ndryshimeve në normat e interesit të këtyre titujve, ndaj rënia e normave të interesit ka patur një ndikim pozitiv në portofolin e investimeve.

Përgjatë muajit Korrik në tregun vendas, normat e interesit të titujve të emetuar nga Qeveria Shqiptare paten një trend miqs. Yield i Bonos së Thesarit 12-mujore rezultoi në 3.14% duke u rritur me 0.05% në krahasim me ankandin e muajit Qershor. Për sa i përket obligacioneve, yield i obligacionit 2 vjeçar rezultoi në 3.88%, duke rënë me 0.05% krahasuar me yield-in në ankandin paraardhës. Ankandi i obligacionit 10-vjeçar rezultoi në 6.00%, duke rënë me 0.60% krahasuar me ankandin paraardhës. Ndërsa ankandi i obligacionit referencë 3-vjeçar rezultoi në 4.462%, duke u rritur me 0.03% krahasuar me ankandin e fundit dhe ankandi i obligacionit referencë 5-vjeçar rezultoi në 4.616%, duke rënë me 0.06% krahasuar me ankandin e fundit.

Grafiket më poshtë japin një pasqyrë të ecurisë së normave të interesit të bonove dhe obligacioneve të thesarit të emetuar nga Qeveria Shqiptare gjatë periudhës 1-vjeçare Korrik 2022 – Korrik 2023. Për obligacionet referencë 3 dhe 5 vjeçare janë paraqitur yield-et fikse të perlogaritura nga kuotimet e kontributoreve në fund të muajit Korrik.




Performanca e fondit dhe ecuria e çmimit të kuotës deri ne 31 Korrik 2023


Kthimi neto me baze vjetore, per periudhen 31 Korrik 2022 – 31 Korrik 2023 eshte **5.35%** ndersa kthimi vjetor per nje periudhe 2 vjecare eshte **2.10% p.a.**

Çmimi i kuotes se fondit Vizion eshte rritur me **+0.73%** gjate muajit Korrik, si pasoje e rënies se normave te interesit te bonove dhe obligacioneve te emetuara nga Qeveria Shqiptare.

Duhet patur parasysh se norma e kthimit ndryshon ne varesi te kushteve te tregut, sic jane ndryshimet e normave te interesit te titujve te borxhit te emetuar nga Qeveria Shqiptare. Keshtu kur normat e interesit ne treg rriten, vlera e titujve te portofolit ulet dhe per rrjedhoje ulet dhe norma e kthimit per periudhen e kaluar. E kunderta ndodh kur normat e interesit ulen. Per pasoje, çmimi i kuotes mund te jete i luhatshem. Luhatshmeria eshte pjese e natyrshme e fondeve te investimit dhe eliminimi i saj eshte i pamundur, keshtu çmimi i kuotes mund edhe te bjere, jo vetem te rritet.



Kthimi vjetor historik i Fondit Raiffeisen Vizion per çdo vit



Fondi Vizion aplikon nje periudhe minimale qendrimi ne fond prej 2 vitesh. Cdo shlyerje perpara permbushjes se periudhes 2-vjet, do te jetë subjekt i nje tarife dalese prej 2% e vleres se kuotave te shlyera.

Pertej minimumit kohor te qendrimit ne fond, Investitoret e fondit Vizion dhe te gjithe fondeve te administruara nga Raiffeisen Invest keshillohen te kene nje horizont sa me te gjate investimi per te perfituar nje kthim optimal nga investimi dhe ne kete menyre ne periudhe afatmesme apo afatgjate te kene mundesi te rikuperojne edhe efektet negative te krijuara afatshkurter.

Per fondin Vizion ky horizont i rekomanduar i qendrimit ne fond eshte te pakten 3 vjet, duke patur parasysh natyrën afatgjatë të investimeve të parashikuara në strategjinë e investimit të fondit dhe ne menyre qe te permbushet objektivi i performancës së fondit.

Investitoret inkurajohen qe te ruajne investimin e tyre duke mos ndryshuar objektivin e qendrimit ne fond, sepse ne kete menyre nuk do te rrezikojne te dalin nga fondi ne momentin e gabuar per investimin e tyre.

Të dhënat per kthimin nga investimi në të shkuarën janë vetëm ilustrative dhe nuk përfaqësojnë nje premtim apo garanci per kthimin ne te ardhmen. Te gjithe shembujt e tjere numerike, jane perdorur per qellime ilustrative dhe analize te te dhenave historike, dhe nuk duhen perdorur nga investitoret per te nxjerre konkluzione per te ardhmen.

Investitorët e mundshëm duhet të lexojnë Prospektin dhe Rregullat e Fondit. Raiffeisen Invest dhe forca shitëse e fondit nuk garantojne nje kthim te caktuar te fondit.

Informacioni mbi cmimin e përditësuar të kuotës, prospektin dhe rregullat e Fondit gjendet pranë zyrave të Raiffeisen Invest sha., në web site www.raiffeisen-invest.al ose në degët e Raiffeisen Bank në Shqipëri.